

VENDIM
Nr. 447, datë 22.7.2021

**PËR KRITERET E DHËNIES SË BURSIVE PËR SHTETASIT E HUAJ ME
ORIGINË SHQIPTARE, PËR TË STUDIUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË,
NGA AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS PËR VITIN AKADEMIK 2021–2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ë”, të nenit 5, ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e 9 (nëntë) bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë për vitin akademik 2021–2022.

2. Bursa e studimit për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare përfshin mbulimin financiar për tarifën e studimeve, si dhe shpenzimet e akomodimit e të ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik, në masën e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Për vitin akademik 2021–2022 të akordohen 9 (nëntë) bursa për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë për vendet, si më poshtë vijon:

- a) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Ukraina;
- b) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të komunitetit arbëresh në Itali;
- c) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare në Kroaci;
- ç) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Bullgari;
- d) 1 (një) bursë studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Turqia.

4. Misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara në vendet e përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, bëjnë propozimet për kandidatët për përfitimin e bursës për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për vitin akademik 2021–2022. Ato janë përgjegjëse për dërgimin e dokumentacionit të kërkuar për kandidatët përfitues të bursës.

5. Dokumentacioni që do të paraqitet nga aplikantët duhet të jetë i legalizuar në përputhje me legjislacionin që rregullon njohjen dhe përdorimin e dokumenteve zyrtare të lëshuara jashtë vendit.

6. Kriteret bazë për përfitimin e bursës që duhet të plotësojë aplikanti janë, si më poshtë vijon:

- a) të ketë mbaruar arsimin e mesëm të lartë me një mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë) ose të barasvlershme me të;

- b) të mos jetë i diplomuar në një program studimi të të njëjtit cikël studimi që aplikon;
- c) të jetë kandidat për student nga shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga vendet për të cilat ofrohen bursa, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

7. Kriteret për përfitimin e bursave, sipas programeve ku do të studiojnë shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës (AKD) dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Për ndjekjen e procesit dhe vlerësimin përfundimtar të dokumenteve të kandidatëve, të cilët do të përfitojnë bursë studimi, institucionin e arsimit të lartë dhe programin e studimit, ku do të studiojnë, krijohet Komisioni i Bursave për Diasporën, me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për diasporën, ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ai përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët do të propozohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (1 anëtar), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (1 anëtar) dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës (1 anëtar).

8. Agjencia Kombëtare e Diasporës të mbulojë tarifën për ndjekjen e këtij kursi.
9. Financimi i bursave në zbatim të këtij vendimi, për vitin akademik 2021-2022, ka një vlerë prej 71 520 (shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet) eurosh. Ky financim do të përballohet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.
10. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKS 1
 MASA E BURSËS PËR SHTETASIT E HUAJ ME ORIGINË SHQIPTARE

Nr.	Studentët me origjinë shqiptare	
	Tarifa e studimit	40000 lekë/vit = 30 euro/muaj
	Akomodimi	300 euro/muaj
	Shpenzimet ushqimore	270 euro/muaj
	Totali mujor i bursës	600 euro/muaj
	Totali vjetor i bursës	64800 euro

Nr.	Asistentët për mësimin e gjuhës shqipe	
	Paga mujore	560 euro/muaj
	Paga vjetore 1 asistent	6720 euro
	TOTALI (vlera vjetore totale për studentët dhe asistentët)	71520 euro